

Kontakt sh.p.k
Raporti i Auditimit
Dhe
Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

Tiranë 22 Mars 2021

Kontakt sh.p.k

Përmbajta

	<u>Faqe</u>
Raporti i auditorit të pavaruar	3-4
Pasqyra e Pozicionit Financiar më datë 31 Dhjetor 2020	5
Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	6
Pasqyra e ndryshimit të kapitaleve të veta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	7
Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	8
Shënime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2020	9-25

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Ortakëve të shoqërisë: Kontakt sh.p.k

Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi Magnet, Tiranë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Kontakt sh.p.k, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2020, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. në besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2019 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pa kualifikuar mbi ato pasqyra në 12 mars 2020.

Informacione të tjera

Informacionet e tjera përfshijnë informacione që përfshihen në Raportin Vjetor të Shoqërisë, por nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe në raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë konkluzion që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart, kur ato na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit, ose nëse duket se ato përmbajnë anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali material, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me palët e ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.



Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendëshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me Drejtimin Shoqërisë përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë

Datë 22 Mars 2021

UHY Elite sh.p.k.

Auditues Ligjorë



Kontakt sh.p.k

Pasqyra e Pozicionit Financiar më datën 31 Dhjetor 2020


(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

		31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktive afat gjatë			
Aktive afat gjatë materiale	7	145,360,907	128,419,634
Aktive afat gjatë materiale të investuara	7	134,316,953	141,386,261
Truall	7	4,743,041	-
Aktive afatgjatë jo materiale	8	255,457	300,538
		284,676,358	270,106,433
Aktive afat shkurtër			
Llogari të arkëtueshme	9	46,945,372	37,893,824
Llogari të tjera të arkëtueshme	10	119,797,560	71,648,431
Aktive të tjera financiare afat shkurtër	11	-	85,239,000
		166,742,932	194,781,255
Inventari			
Lëndë e parë	12	35,891,913	20,184,006
Prodhim në proces	12	1,719,632,491	1,208,958,136
Produkt i patshëm	12	1,157,578,548	158,988,295
Parapagesat për furnizime	12	16,945,764	17,041,920
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	12	1,195,922,085	1,222,972,968
		4,125,970,801	2,628,145,325
Mjete monetare	13	61,663,763	48,951,953
		4,639,053,854	3,141,984,966
KAPITALET E VETA			
Kapitali	14	659,221,542	659,221,542
Rezerva ligjore	14	1,253,178	1,253,178
Fitime të pashpërndara	14	132,106,117	159,174,214
Fitime/(Humbje) e vitit financiar	14	177,433,522	68,179,800
		970,014,359	887,828,734
DETYRIME			
Detyrime afat gjatë			
Hua afta gjatë	15	-	519,628,924
Grante dhe të ardhura të shtyra	15	1,082,622	505,589
		1,082,622	520,134,513
Detyrime afat shkurtër			
Llogari të pagueshme (furnitorë)	16	73,537,654	139,730,600
Detyrime ndaj organeve tatimore	17	14,898,052	5,706,918
Të tjera detyrime afta shkurtër	18	468,096,023	348,136,484
Hua afat shkurtër	18	-	50,220,262
Detyrime kundrejt punonjësve	18	-	749,710
Parapagime të arkëtuara	18	3,111,425,144	1,189,477,745
		3,667,956,873	1,734,021,719
		3,669,039,495	2,254,156,232
		4,639,053,854	3,141,984,966

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 9-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtuesit e Kontakt sh.p.k më datë 15 Mars 2021 dhe janë firmosur nga:


Ing. Fatmir Bektashi
Administrator


KM Suzana Aliaj
Drejtor Finance

Kontakt sh.p.k

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në 31.12.2020

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

		<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Të ardhurat			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	1,382,625,786	1,267,012,463
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	22,027,176	18,788,634
Ndryshim në punë në proces	19	2,128,691,854	1,017,550,558
Ndryshim në inventar produkt i gatshëm	19	(945,104,074)	(968,077,382)
		2,588,240,742	1,335,274,273
Shpenzimet për aktivitetin kryesor			
Mallra, lënda e parë dhe shërbime	20	(611,876,945)	(295,789,291)
Punime ndërtimi	20	(725,554,416)	(367,178,341)
Shpenzime personeli	21	(249,457,268)	(158,134,930)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	22	(703,464,338)	(548,685,408)
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	7	(37,594,197)	(34,991,146)
		(2,327,947,164)	(1,404,779,116)
Fitimi (Humbja) nga aktiviteti kryesor		260,293,578	(69,504,843)
Të ardhurat dhe (shpenzimet) financiare	23	(49,700,329)	164,407,331
		(49,700,329)	164,407,331
Fitimi përpara tatimit		210,593,249	94,902,488
Shpenzime të panjohura		10,471,591	83,248,759
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	(33,159,727)	(26,722,688)
Fitimi neto i vitit		177,433,522	68,179,800
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE			
Fitimi neto i vitit		177,433,522	68,179,800
Diferenca konvertimi nga operacionet jashtë njësisë		-	-
Rivlerësime të pasurive të paluajtshme		-	-
Tatim mbi të ardhurat gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën		177,433,522	68,179,800

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 9-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Kontakt sh.p.k

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e veta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rasisë kur specifikohet monedha tjetër)

	Kapital	Rezerva Ligjore	Fitimi i pashpërndarë	Rezultati i vitit	Totali
Balanca në 31 Dhjetor 2018	659,221,542	1,253,178	159,174,214	0	819,648,934
Fitim për vitin 2019	0	0	0	68,179,800	68,179,800
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse	0	0	0	0	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	0	0	0	68,179,800	68,179,800
Kontribute / shpërndarje tek aksionaret					
Dividend të paguar aksionarëve	0	0	0	0	0
Krijimi dhe (përdorimi) i rezervave	0	0	0	0	0
Totali i kontributeve dhe shpërndarjes për aksionaret	0	0	0	0	0
Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit					
Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit	0	0	0	0	0
Totali i ndryshimeve në zotërimin e aksioneve	0	0	0	0	0
Totali i transaksioneve me aksionaret	0	0	0	0	0
Balanca ne 31 Dhjetor 2019	659,221,542	1,253,178	159,174,214	68,179,800	887,828,734
Fitim për vitin 2020	0	0	0	177,433,522	177,433,522
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse	0	0	0	0	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	0	0	0	177,433,522	177,433,522
Kontribute / shpërndarje tek aksionaret					
Dividend të paguar aksionarëve	0	0	(27,068,097)	(68,179,800)	(95,247,897)
Krijimi dhe (përdorimi) i rezervave	0	0	0	0	0
Totali i kontributeve dhe shpërndarjes për aksionaret	0	0	(27,068,097)	(68,179,800)	(95,247,897)
Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit					
Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit	0	0	0	0	0
Totali i ndryshimeve në zotërimin e aksioneve	0	0	0	0	0
Totali i transaksioneve me aksionaret	0	0	0	0	0
Balanca ne 31 Dhjetor 2020	659,221,542	1,253,178	132,106,117	177,433,522	970,014,359

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e veta duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 9-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Kontakt sh.p.k

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Mjete monetare nga aktiviteti kryesor		
Fitimi nga aktiviteti kryesor	<u>210,593,248</u>	<u>94,902,487</u>
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizim	37,594,197	34,991,146
Shpenzime per tatim fitimin	2,870,321	
Fitim/Humbje nga shitja e AAM	(2,171,299)	(530,949)
Të ardhura nga investime	-	(4,683)
Shpenzime të maturuara	-	4,300
Fitim/Humbje nga rivlerësimi	-	8,457
<i>Ndryshime në kapitalin qarkullues:</i>		
Rënie (ritje) në llogari te arkëtueshme	28,038,323	(103,775,470)
Rritje në inventarë	(1,497,825,475)	(33,116,672)
Rritje në llogari të pagueshme	1,933,935,155	34,550,840
<i>Rregullime të kapitalit qarkullues:</i>		
Tatimi fitimi i paguar	(36,030,044)	(26,633,154)
Mjete monetare nga aktiviteti kryesor	<u>677,004,427</u>	<u>396,302</u>
Aktiviteti investues		
Blerje aktive afatgjatë materiale	(56,863,705)	(29,676,024)
Shitja e aktiveve afatgjatë materiale	6,870,878	4,603,754
Mjete monetare nga aktiviteti investues	<u>(49,992,827)</u>	<u>(25,072,270)</u>
Aktiviteti financues		
Veprimtari financiare	(519,051,893)	58,726,973
Dividend i paguar	(95,247,897)	-
Mjete monetare nga aktiviteti finacues	<u>(614,299,790)</u>	<u>58,726,973</u>
Rritje (rënie) neto në mjete monetare	12,711,810	34,051,006
Mjete monetare në fillim të periudhës	<u>48,951,953</u>	<u>14,900,947</u>
Mjete monetare në fund të periudhës	<u>61,663,763</u>	<u>48,951,953</u>

Pasqyra e rrjedhjes së parase duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 9-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Kontakt sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2020

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rasteve kur specifikohet monedha tjetër)

1. Të përgjithshme

Kontakt sh.p.k është themeluar më 07 Qershor 1999 në Tiranë, me objekt në fushën e ndërtimit, punime ndërtimi, projektme, prodhim materiale ndërtimi, mbikëqyrje, kolaudim, etj. Kontakt sh.p.k është regjistruar në QKB më 21 Dhjetor 2000, me NIPT: J92108006V dhe adresa e selisë është Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi Magnet, Tiranë. Kontakt sh.p.k drejtohet nga administratori, Z. Fatmir Bektashi, i cili është gjithashtu ortaku i vetëm i shoqërisë. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka patur 176 të punësuar.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata për pajtueshmëri

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike, përjashtuar derivativët financiar (n.q.s ka), instrumentat financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit e humbjes dhe aktivet financiare të vlefshme për shitje, të cilat maten me vlerë të drejtë (n.q.s ka).

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në LEK e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

(d) Përdorimi i gjykimeve dhe hamendësimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi dhe në cdo periudhë të ardhme që preket.

(e) Vijueshmëria

Vitin e kaluar një gjendje pandemike u shpall në të gjithë botën dhe në Shqipëri. Kjo situatë preku çdo biznes në mënyra të paparashikueshme.

Në Mars 2020, Qeveria e Shqipërisë mori masa drastike duke pezulluar shumë aktivitete biznesi, megjithatë, shoqëria vazhdoi funksionimin e saj normal gjatë gjithë vitit. Aktiviteti i shoqërisë ka vazhduar pa ndalesa gjatë vitit 2020, dhe ka pasur një performancë relativisht të qëndrueshme në shitje dhe ka arritur të arrijë rezultate shumë pozitive.

Për vitin 2021, shoqëria nuk pret që të ketë devijim nga shifrat e buxhetuara për shkak të situatës pandemike, e cila megjithatë nuk është e mundur të matet në mënyrë të besueshme dhe plotësisht për momentin. Sidoqoftë, drejtuesit besojnë fuqimisht se rezultatet pozitive do vijojnë.

Drejtuesit e shoqërisë kanë bërë një vlerësim të aftësisë së shoqërisë për të vijueshmërinë e aktivitetit duke marrë parasysh të gjithë faktorët e theksuar më lart dhe janë të kënaqur që shoqëria ka burime për të vazhduar aktivitetin për një të ardhme të parashikueshme. Për më tepër, drejtuesit nuk janë në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime të mëdha mbi vijueshmërinë e shoqërisë. Prandaj, Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijueshmërisë.

3. Ndryshimet në politikat kontabël dhe në dhënien e shpjegimeve shtesë

(a) Standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara

Njësia ekonomike ka aplikuar për herë të parë, disa standarde dhe ndryshime, të cilat janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2020 e më pas. Njësia ekonomike nuk ka zbatuar më herët ndonjë standard, interpretim ose ndryshim tjetër që është publikuar, por që nuk është ende efektiv.

Kontakt sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2020

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

3. Ndryshimet në politikat kontabël dhe në dhënien e shpjegimeve shtesë (vazhdon)

(a) Standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara

Ndryshimet në SNRF 7, SNRF 9 dhe SNK 39 Reforma e Normës Standarde të Interesit.

Ndryshimet në SNRF 9 dhe SNK 39 Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja sigurojnë një numër lehtësimesh, të cilat zbatohen për të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse që preken drejtpërdrejt nga reforma e normës standarde të interesit.

Një marrëdhënie mbrojtëse ndikohet nëse reforma jep shkas për pasiguri në lidhje me kohën dhe/ose shumën e flukseve monetare të bazuar sipas normës standarde të zërit të mbrojtur ose instrumentit mbrojtës. Këto ndryshime nuk kanë asnjë ndikim në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike, pasi njësisia ekonomike nuk ka ndonjë instrument të lidhur me normën e interesit.

Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 Përkufizimi i Materialitetit

Ndryshimet ofrojnë një përkufizim të ri të materialitetit që shpreh, "informacioni është material nëse kur harrohet, deklarohet gabim ose fshihet, mund të ndikojë në vendimet e pritshme që përdoruesit kryesor të pasqyrave financiare për qëllim të përgjithshëm, bëjnë mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare, të cilat sigurojnë informacione financiare për njësinë ekonomike raportuese." Ndryshimet sqarojnë se materialiteti do të varet nga natyra ose madhësia e informacionit, qoftë individualisht ose në kombinim me informacione të tjera, në kontekstin e pasqyrave financiare. Deklarim i gabuar i informacionit është material nëse në mënyrë të qëllimshme pritet që të ndikojë në vendimet e kryera nga përdoruesit kryesorë. Këto ndryshime nuk kishin asnjë ndikim në pasqyrat financiare dhe as nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të ardhshëm në njësinë ekonomike .

Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar i publikuar më 29 Mars 2018.

Kuadri Konceptual nuk është standard dhe asnjë nga konceptet që përmbahen në të nuk i tejkalon konceptet ose kërkesat në ndonjë standard. Qëllimi i Kuadrit Konceptual është të ndihmojë IASB në zhvillimin e standardeve, të ndihmojë përgatitësit në zhvillimin e politikave kontabël të qëndrueshme atje ku nuk ka ndonjë standard të zbatueshëm dhe të ndihmojë të gjitha palët që të kuptojnë dhe interpretojnë standardet. Kjo do të ndikojë në ato njësi ekonomike të cilat zhvillojnë politikat e tyre të kontabilitetit bazuar në Kuadrin Konceptual. Ndryshimet në Kuadrin Konceptual përfshijnë disa koncepte të reja, përkufizime dhe kritere të përditësuara të njohjes për asetet dhe detyrimet dhe sqaron disa koncepte të rëndësishme. Këto ndryshime nuk kishin asnjë ndikim në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

Ndryshimet në SNRF 16 për Koncesionet e Qirave që lidhen me Covid-19

Më 28 maj 2020, IASB nxori ndryshime të SNRF 16 Koncesionet e qirasë që lidhen me Covid-19.

Ndryshimet paraqesin lehtësime për qiramarrësit që zbatojnë kërkesat e SNRF 16 për të ndryshuar kontabilitetin e koncesioneve të qirasë si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid-19. Si një mjet praktik, një qiramarrës mund të zgjedhë të mos vlerësojë si ndryshim të termave të qirasë nëse këto ndryshime nga ana e qiradhënësit ishin të lidhura me Covid-19.

Ndryshimi zbatohet për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë nga 1 qershorit 2020 e më pas. Aplikimet e më hershme janë të lejuara. Ky ndryshim nuk kishte asnjë ndikim në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

Kontakt sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2020

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

3. Ndryshimet në politikat kontabël dhe në dhënien e shpjegimeve shtesë (vazhdon)

(b) Standardet e nxjerra por ende efektive

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Njësisë ekonomike zbulohen më poshtë. Njësia ekonomike synon të zbatojë këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të bëhen efektive.

SNRF 17 Kontratat e Sigurimit

Në maj 2017, BSNK lëshoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 17), një standard të ri gjithëpërfshirës i kontabilitetit për kontratat e sigurimeve që përfshijnë njohjen dhe matjet, prezantimin dhe zbulimin. Pasi të jetë efektive, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) i cili ka qenë publikuar në 2005, dhe është efektiv për periudhat e raportimit që fillojnë nga 1 janarit 2023 e më pas, me shifrat krahasuese të kërkuara. Aplikimi i hershëm është i lejuar, me kusht që njësia ekonomike të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 pas ose para datës që zbaton për herë të parë SNRF 17. Ky standard nuk është i zbatueshëm për njësinë ekonomike.

Ndryshimet në SNK 1: Klasifikimi i detyrimeve afatshkurtër ose afatgjatë.

Në janar 2020, IASB bëri ndryshime në paragrafët 69 deri 76 të SNK 1 për të specifikuar kërkesat për klasifikimin e detyrimeve afatshkurtër ose afatgjatë.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë nga 1 janarit 2023 e më pas dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive. Njësia ekonomike po vlerëson aktualisht ndikimin që ndryshimet do të kenë në praktikën aktuale dhe nëse marrëveshjet ekzistuese të huasë mund të kërkojnë rinegocim.

Referenca në Kuadrin Konceptual - Ndryshimet në SNRF 3

Në maj të vitit 2020, IASB publikoi *Ndryshime në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - Referenca në Kuadrin Konceptual*.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë nga 1 janarit 2022 e më dhe zbatohen në mënyrë të mundshme. Ndryshimet nuk pritet të kenë ndikim material në njësinë ekonomike.

Ndryshimet në SNK 16 – Pasuri e Paluajtshme, Makineri e Pajisje: Të ardhurat përpara përdorimit të synuar

Në maj të vitit 2020, IASB publikoi *Pasuri e Paluajtshme, Makineri dhe Pajisje - Të ardhura para përdorimit të synuar*, i cili ndalon njësitë ekonomike të zbresin nga kostoja e një elementi të aktiveve afatgjata materiale, çdo të ardhur nga shitja e artikujve të prodhuar gjatë kohës që aktivi është duke u ndërsa sjellë në vendndodhjen e tij dhe kushtet e domosdoshme për të qenë i aftë të funksionojë në mënyrën e parashikuar. Në vend të kësaj, një njësi ekonomike njih të ardhurat nga shitja e artikujve të tillë dhe kostot e prodhimit të këtyre artikujve, në fitim ose humbje të periudhës.

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë nga 1 Janarit 2022 e më pas dhe duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive për ato aktive afatgjatë materiale të vendosura në dispozicion për përdorim në fillimin e periudhës më të hershme të paraqitur kur njësia ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin. Ndryshimet nuk pritet të kenë një ndikim material në njësinë ekonomike.

Kontakt sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2020

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

3. Ndryshimet në politikat kontabël dhe në dhënien e shpjegimeve shtesë (vazhdon)

(b) Standardet e nxjerra por ende efektive (vazhdon)

Ndryshime në SNK 37 Kontratat e vështira - Kostot e përbushjes së një kontrate

Në maj të vitit 2020, IASB lëshoi ndryshime në SNK 37 për të specifikuar se cilat kosto duhet të përfshijë njësia ekonomike gjatë vlerësimit nëse një kontratë është e rëndë ose humbëse.

Ndryshimet janë efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë nga 1 janarit 2022 e me pas. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në kontratat të cilat ende nuk kanë përbushur të gjitha detyrimet e tyre në fillim të periudhës raportuese vjetore në të cilën aplikojnë për herë të parë ndryshimet. Ndryshimet nuk pritet të kenë një ndikim material në njësinë ekonomike.

SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Filiali si zbatues për herë të parë

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë nga 1 janarit 2022 e më pas e lejueshme për tu zbatuar dhe më herët.

Ndryshimet nuk janë të zbatueshme për njësinë ekonomike.

SNRF 9 Instrumentet Financiarë - Tarifat e “10 për qind” të testit për mosnjohjen e detyrimeve financiare

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë nga 1 janarit 2022 ose më pas me leje miratimi më të hershme. Njësia ekonomike do të zbatojë ndryshimet në detyrimet financiare që janë të modifikuara ose shkëmbehen në fillimit të periudhës raportuese vjetore ose më pas në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë ndryshime.

Ndryshimet nuk priten të kenë një ndikim material në njësinë ekonomike.

4. Politikat kontabël të rëndësishme

(a) Transaksionet në monedha të huaja

Gjëndjet e llogarive në monedhë të huaj janë përkthyer në monedhën vendase me kursin zyrtar të mbylljes së Bankës së Shqipërisë në datën e bilancit. Diferencat e konvertimit si pasojë e përkthimit të monedhave të huaj në Lek janë njohur në pasqyrat e të ardhrave dhe shpenzimeve për periudhën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të vlerësuar me koston historike, janë raportuar me kursin historik të monedhës së huaj në datën e transaksionit.

(b) Instrumentat financiarë

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative që përfshijnë llogari klientesh, mjete monetare, dhe llogari të tjera për tu paguar apo për tu arkëtuar me karakter tregtar. Instrumentet financiare jo-derivative janë regjistruar fillimisht siç përshkruhet më poshtë:

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi me pak se tre muaj të cilat nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga shoqëria në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Llogaritë e klientave dhe llogari të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e klientave dhe llogari të tjera të arkëtueshme fillimisht janë regjistruar me vlerën e drejtë dhe më pas janë vlerësuar me koston e tyre të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Llogaritë e furnitorëve dhe të tjera llogari të pagueshme

Llogaritë e furnitorëve dhe të tjera llogari të pagueshme janë regjistruar fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas janë vlerësuar me koston e amortizuar duke përdorur metoden e interesit efektiv.

Kontakt sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2020

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

4. Politikat kontabël të rëndësishme (vazhdon)

(c) Inventarët

Shoqëria ka vlerësuar gjendjet e inventarit në datën e mbylljes së bilancit duke përdorur metodën e më të voglës midis kostos së blerjes dhe vlerës neto të realizueshme.

(d) Ndërtesa, makineri e paisje

(i) Njohja dhe matja

Ndërtesa, makineritë e pajisjet maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe cdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Të gjitha aktivet afat gjatë janë pasqyruar me koston e blerjes. Kosto e blerjes përfshin shpenzimet e lidhura drejt për drejt me blerjen e aktivit.

Kur pjesë përbërëse të aktivit kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato mbahen si zëra të vecantë të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një elementi të aktivit afatgjatë material përcaktohen nga krahasimi i të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbartur të aktivit, dhe paraqiten neto në seksionin e të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave shpenzimeve.

(ii) Kostot vijuese

